



Një atentat mafioz është shënuar ndaj dy vëllezërve mesnatën e së dielës në aksin Elbasan-Peqin. Një 24-vjeçar humbi jetën dhe vëllai i tij mbeti i plagosur në këtë atentat mafioz. Si pasojë e disa plumbave të marrë në pjesë të ndryshme të trupit humbi jetën Klevis Baho 24 vjeç. Gjithashtu nga të shtënat mbeti i plagosur edhe vëllai i viktimës, 29 vjeçari, Sandër Baho. Ky i fundit mori tre plumba në shpatull, por pas ndihmës së parë është jashtë rrezikut për jetën. Dy vëllezërit kanë qenë duke u kthyer për në shtëpi, kur makina me të cilën po udhëtonin u qëllua me breshëri

automatiku pranë fshatit Broshkë në rrugën Elbasan-Peqin. Autorët që mendohet se kanë qenë të paktën dy persona, derdhën pothuajse një karikator kallashnikovi ndaj dy vëllezërve. Dyshohet se objektiv i atentatit mësohet se ka qenë 29- vjeçari, Sandër Baho, i cili kishte shpëtuar edhe një tjetër atentati në Itali. Në vendngjarje u gjetën 30 gëzhoja kallashnikovi me të cilën autorët qëlluan ndaj dy vëllezërve. Policia menjëherë pas ngjarjes ka ngritur postblloqe për të kapur autorët e dyshuar, por ende nuk ka rënë në gjurmët e tyre.

Ngjarja

Klevi Baho i riu që u ekzekutua pak pas mesnate dje në fshatin Broshkë, para atentatit ka qenë në këmbë buzë rrugës Elbasan-Peqin, pranë një karburanti. Teksa një person i maskuar ka ardhur dhe i është drejtuar duke e pyetur nëse ai është Klevi apo jo? 24-vjeçari është përgjigjur se nuk ishte ai personi që kërkonte. Pasi personi i dyshimtë u largua, ai i ka telefonuar vëllait të tij i cili ka shkuar menjëherë drejt tij me automjetin tip “Audi” me targë AA 33 AZ. Të dy kanë hipur në makinë dhe janë larguar në drejtim të banesës së tyre që ndodhet rreth dy kilometra larg nga rruga nacionale. Sapo dy vëllezërit kanë marrë rrugën drejt shtëpisë, pas tyre është vënë një tjetër automjet tip “Benz”, i cili ka nisur të qëllojë me armë teksa makinat ishin në ecje. Me plumba në kokë dhe trup, Klevi Bako ka mundur të dalë nga makina, ndërsa vëllai i tij ka mbetur aty dhe ndihmën e parë ja kanë dhënë familjarët që dolën menjëherë pasi dëgjuan të shtënat. E kanë dërguar me urgjencë pranë Spitalit kirurgjik nga ku raportohet se ka marrë tre plumba në shpatull dhe gjendet nën kujdesin e mjekëve jashtë rrezikut për jetën. Ndërsa prej afro 40 minutash familja Baho nuk ka mundur të gjejnë djalin e vogël të tyre. 24-vjeçari u gjet nga familjarët pas disa kërkimesh poshtë një ure që lidh rrugën nacionale me fshatin. I riu ka qenë me shenja jete dhe familjarët e kanë dërguar me urgjencë në

spitalin rajonal të Elbasanit, por i riu nuk ka mundur t'i rezistojë plagëve të marra dhe aty ka ndërruar jetë.

Hetimet

Menjëherë pas atentatit të bërë ndaj dy vëllezërve Baho, policia e Elbasanit ngriti një grup të posaçëm hetimor i cili nisi punën për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e kapje ne autorëve, të cilët dyshohet të kenë qenë të paktën dy persona. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se drejt automjetit tip “Audi” me të cilin po udhëtonin dy vëllezërit është qëlluar të paktën 30 herë, pasi në vendin e ngjarjes u mbledhën plot 30 gëzhoja. Mëngjesin e djeshëm janë shoqëruar për tu marrë në pyetje disa persona kryesisht banorë të fshatit dhe familjarë të viktimës për të mësuar rreth konflikteve të këtij të fundit. Ndërkohë grupi hetimor ka sekuestruar edhe kamerat e sigurisë së karburantit ku Klevis Baho kishte qenë pak para se të ekzekutohej me breshëri kallashnikovi. 24-vjeçari sapo kishte dalë nga burgu në Itali, ku ishte dënuar për trafik droge. Ndërkohë dyshohet se objektivi i këtij atentati ishte vëllai i plagosur Sandër Baho. Ky i fundit i kishte shpëtuar dhe një atentati në Itali pak vite më parë. Sipas hetimeve prishja e pazareve të drogës dyshohet se është pista kryesore që policia po punon për zbardhjen e kësaj ngjarjeje, ndërkohë që hetimet janë në vijim.

Elvis Myrta

YOU MAY LIKE

by **mgid**

Milioner iz Beograd otkriva kako
zarađuje 400 evra na sat